



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman**

VENDIM

Nr 15 Datë 19/12/2007

“Për miratimin në parim të kërkesës, për përdorim të rezervave ujore, me konçesion, për prodhim hidroenergjie në H/C ne perroin e Nishoves ,Lumin Osum Vepra Nr 1 dhe Nr 2 Skrapar.

Në mbështetje të neneve 8 dhe 16 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe të & III, pika 2.8.B të vendimit nr. 3, datë 19.07.2002 të K KU “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit Teknik të K KU, Këshillavë të Baseneve Ujëmbledhëse dhe Agjencive të Ujit”, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin në parim të kërkesës, për përdorim të rezervave ujore, me konçesion, për prodhim hidroenergjie në H/C ne perroin e Nishoves Skrapar.

- 1-Sasia e ujit për përdorim ne perputhje me kerkesat ne sezonin e vaditjes,rakorduar me cdo vit me Bordin e Kullimi Ersek.
- 2-Prurje llogaritur per shrytezim 0.22 m3/sek deri 0.34 m3/sek
- 3-Kuota e hyrjes ne vepren e marjes 510 m.
- 3-Ngarkohet AUB Seman për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI AUB
SEMAN
Ajen GRABOVA**



**KRYETARI I KBU
SEMAN
Shahin BEJDAJ**

